



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.521/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kundër Iniciativa Qytetare “Komuniteti i Bashkuar”-Adrijana Hodzic”, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor - posterit në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e pasafatshme ankesa, e identifikuar me numër A.nr521/2021, e datës 16.02.2021, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kundër Iniciativa Qytetare “Komuniteti i Bashkuar”-Adrijana Hodzic”, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor - posterit në rrugë publike.

A r s y e t i m

Me datë 16.02.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, në të cilin parashtruesi i ankesës pretendon se Iniciativa Qytetare “Komuniteti i Bashkuar”-Adrijana Hodzic”, me datën 09.02.2021, kanë vendosur disa postera të ngjitura në pronë publike, përkatësisht te ngjitur ne hyrje te ndërtesave dhe ne shtylla elektrike. Me këtë rast nga ana e këtij subjekti është bërë shkelja e nenit 4 pika b) e Rregullores Zgjedhore Nr.11/2013. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kundër Iniciativës Qytetare “Komuniteti i Bashkuar”-Adrijana Hodzic”, e datës 16.02.2021, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat” i cili përcakton se: “Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar”.. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi ankesën e ka dorëzuar me postë me datë 13.02.2021 dhe e njëjta është paraqitur pranë PZAP-it me datën

16.02.2021, ndërsa afati prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti kur ka ndodhur shkelja e supozuar në ankesë ka qenë me datën 09.02.2021, që do të thotë se ankuesi, ankesën e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat”.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 6 paragrafi 4 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat, nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 521/2021 me datë 18.02.2021

**Kryesuese e Panelit
Kymetë Kicaj**

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet e drejta në ankesës.

